DHOMA KOMBËTARE PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 16023 Prot.
Datë 18.10.2021

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
Tirana BAILIFF'S

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

Nr. 101 Regj.
Nr. 1786 Prot.

Tiranë më 12.10.2021

**URDHËR**
**PËR HEQJE SEKUESTRO KONSERVATIVE**

**Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit**
Për dijeni: Shoqëria "Vega" sh.p.k., me NIPT K01524006L
Për dijeni: Aleksandër Vehbi Gavoçi i dtl. 22.07.1962
Për dijeni: "Raiffeisen Bank" sh.a.

Unë Natasha Laska, në cilësinë e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë "Zyrës së Përmbarimit Privat Tirana Bailiff's" sh.p.k., në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 1246 Akti datë 24.02.2017, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër,* duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 101 datë 25.03.2019, kërkesën e kreditorit Raiffeisen Bank sh.a., ndaj debitorit, hipotekuesit, barrëdhënësit Shoqëria "Vega" sh.p.k., si dhe ndaj dorëzanësit, hipotekuesit, pengdhënësit Aleksandër Vehbi Gavoçi (referuar së bashku si "debitor"), lidhur me titullin ekzekutiv Kontratë Kredie me Kufi Nr. 4213 Rep. Nr. 1832 Kol. datë 30.10.2014 e ndryshuar.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 101 Regj. Nr. 434 Prot. datë 26.03.2019, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 1246 Akti datë 24.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA SE:**

Me shkresën Nr. 101 Regj., Nr. 434 Prot., datë 26.03.2019 "*Lajmërim për ekzekutim vullnetar të detyrimit"* debitori shoqëria "VEGA" sh.p.k. dhe dorëzanësi Z. Aleksandër Vehbi Gavoçi janë lajmëruar të shlyejnë vullnetarisht detyrimin e marrë përsipër ndaj kreditorit "Raiffeisen Bank" sh.a., brenda 10 ditëve pas të cilave do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm. Shoqëria "Vega" sh.p.k ka marrë njoftim më datë 28.03.2019 sipas letërporosisë, pranë selisë së shoqërisë, të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ndërsa Z. Aleksandër Vehbi Gavoçi ka marrë njoftim pranë selisë së shoqërisë "VEGA" sh.p.k. më 28.03.2019, si edhe pranë adresës së deklaruar në Gjendjen Civile më 29.03.2019, të konfirmuara me letërporosi.

Në këto kushte në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm me vendimin Nr. 101 Regj. Nr. 490 Prot. datë 09.04.2019, duke urdhëruar vënien e masës së sekuestrove mbi pasuritë e paluajtshme të debitorve.

**Në datën 12.10.2021, nëpërmjet komunikimit elektronik, kreditori "Raiffeisen Bank" sh.a. ka kërkuar heqjen e sekuestros konservative nga llogaritë bankare, pronat, barrët siguruese, aksionet në QKB dhe të gjitha sekuestrot që mund të jenë vënë në asetet e Shoqërisë "Vega" sh.p.k. dhe Aleksandër Gavoçi.**

Për sa më sipër,

**URDHËROJ:**

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative në pjesët/kuotat/aksionet që **Aleksandër Vehbi Gavoçi, i dtl. 22.07.1962,** zotëron tek **Shoqëria "Al-Çelik-Vega" sh.a. me NIPT K78520301N; Shoqëria "CLEANLINESS" sh.p.k. me NIPT L22830001P; Shoqëria "S.A.R Ndërtim" sh.p.k. me NIPT L71816017D,** të vendosur nga përmbaruesi gjyqësor me shkresën Nr. 101 Regj. Nr. 512 Prot. datë 09.04.2019;

4. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

**5. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe cdo veprim apo mosveprim që do të kryhet në kundërshtim me këtë urdhër do të sjellë përgjegjësi penale për personat përgjegjës sipas nenit 320 të Kodit Penal;**

**"Zyrë e Përmbarimit Privat Tirana Bailiff's" sh.p.k.**
**PËRMBARUES GJYQËSOR**
**NATASHA LASKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - NATASHA LASKA - PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT